



Empowering through Freedom, Justice and Sincerity

PROTOKOLLI I KONFERENCËS

Prezantimi i dokumentit kërkimor:

“ETIKA NË SISTEMIN ARSIMOR NË SHQIPËRI”

13 Prill 2017

Hotel Tirana International

10.00 – 13.00

Më 13 prill 2017, në Hotel Tirana International u organizua konferenca kushtuar gjetjeve të studimit në rang kombëtar: *“Etika në sistemin arsimor në Shqipëri.”*. Studimi u ndërmor dhe u udhëhoq nga **Fondacioni Mary Ward Loreto** në partneritet me **Ministrinë e Arsimit dhe të Sporteve**. Studimi u krye nga ACER – **Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike** – e drejtuar nga Dr. Zef Preci.

Konferenca u hap në orën 10.15 am dhe u ndoq nga aktorë të ndryshëm të interesuar, akademikë dhe hulumtues të njohur, institucione dhe organizata të shoqërisë civile që punojnë në fushën e arsimit dhe janë të përfshira drejtë përdrejtë në projekte dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve dhe për një edukim dhe të ardhme më të mirë për fëmijët në Shqipëri.

✚ (bashkëngjitur lista e pjesëmarrjes në konferencë).

PËRSHËNDETJET E MIRËSEARDHJES – Prezantimi i panelit të konferencës dhe agjendës

Sokol Pellumbi—moderator i konferencës – mirëpriti të gjithë pjesëmarrësit dhe i falendëroi ata për praninë e tyre dhe interesin e shfaqur. Ai nënvizoi rëndësinë e hulumtimit, i pari në llojin e tij mbi këtë çështje në Shqipëri. Pas fjalëve të mirëseardhjes, ai u prezantoi pjesëmarrësve anëtarët e panelit të konferencës:

Nora Malaj	Zëvendës Ministër i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS)
Imelda Poole	Presidente e Fondacionit Mary Ward Loreto
Dr. Zef Preci	Drejtor Ekzekutiv i ACER—Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike
Dr. Gerda Sula	Koordinatorë projekti, Projekti i MWLPër Arsimin

Moderatori diskutoi agjendën, duke theksuar faktin se kjo konferencë ishte ndryshe nga të tjerat pasi ishte e ndërtuar mbi disa panele dhe diskutime të thelluara në tryeza të rrumbullakëta. Sesioni i parë do të ndiqej nga prezantimi i hulumtimit, duke u përqendruar mbi metodologjinë e tij, gjetjet dhe përfundimet. Prezantuesit ishin Dr. Skerdi Zahaj dhe Dr. Blerta Bodinaku, dy prej hulumtuesve të ACER për këtë studim. Pas këtij prezantimi, kishte diskutime paralele në tryeza të rrumbullakëta të ndara sipas grupve të veçanta të interesit. Pyetjet e ngritura gjatë diskutimeve në tryezat e rrumbullakëta do të trajtoheshin më pas nga paneli i këtij sesioni.

Mary Ward Loreto Foundation

Website: www.albaniahope.com Email: info@marywardloreto.net

FB: MaryWardLoreto Address: Rr. Skenderbej, Pall. 8, Shk. 2, Ap. 5 Tel: +355 44 500 388



Empowering through Freedom, Justice and Sincerity

Më pas, fjala iu dha Imelda Poole, Presidente e Fondacionit MWL.

PËRSE KY HULUMTIM

Imelda Poole – Presidente e Fondacionit MWL

Imelda Poole falendëroi të gjithë pjesëmarrësit, prania e të cilëve në konferencë ishte mëse e mirëpritur. Ajo i informoi pjesëmarrësit rreth mungesës së Ministres Lindita Nikolla për shkak të një angazhimi të momentit të fundit në Ministri.

Ajo më pas deklaroi:

“Ky është një studim i jashtëzakonshëm rreth kodit të etikës përsa i përket sistemit arsimor në Shqipëri. Ka qenë një rrugëtim i gjatë deri në prodhimin e këtij dokumenti, i cili nuk do të kishte qenë i mundur pa bashkëpunimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Do të dëshiroja të përgëzoja veçanërisht Bordin e MWL për Arsimin: Shpresa Delia, Alfred Matoshi, Steve Corrielle dhe Anila Kashnjeti, të cilët, gjatë procesit të drejtimit të këtij studimi profesional patën mençurinë të vepronin mbi nevojën për ndryshim.

“Shkolla e parë në të cilën kam dhënë mësim, të cilën e konsideroj dhe model se si duhet kryer arsimit, kishte në zemër të saj filozofinë Jezuite të arsimit, e cila mbështetet mbi të njëjtat vlera si ato të Mary Ward. Këto vlera të lirisë, drejtësisë dhe sinqeritetit janë rruga drejt së vërtetës. Vlerat themelore të hulumtimit, që janë subjekt i konferencës së sotme, janë të njëjta, duke përfshirë ato të lumturisë, respektit dhe dhembshurisë. Këto janë vlera njerëzore themelore.

“Kështu, kur mendojmë rreth mungesës së etikës në të gjitha nivelet e shkollave në Shqipëri, duhet të pranojmë se mund të bëjmë më shumë. E dimë dhe se ku gjendet zgjidhja. Shtëpia është bazamenti për shkollën e jetës. Si drejtues në shoqërinë shqiptare, kemi përgjegjësi që të mbështesim këtë bazament familiar, me qëllimin për të siguruar se të gjithë qytetarët e Shqipërisë i gëzohen një mjedisi të shëndetshëm dhe etik, sidomos nëpër shkolla. Mbani këto aspekte positive në mendje si udhëzues drejt ndryshimit.”

RËNDËSIA E HULUMTIMIT PËR NDRYSHIM SISTEMIK NË FUSHËN E ARSIMIT NË SHQIPËRI

Nora Malaj – Zëvendës Ministër i MAS

Kjo javë është cilësuar “Java e Arsimit” sepse Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka vendosur që të promovojë një qasje të ndryshme në punën me të gjithë partnerët dhe komunitetet që do të përfitojnë nga reformat. Qasja e re kërkon që prindërit të jenë të gatshëm që të pranojnë kurrikulën e re dhe të masin vlerën dhe efektin e çdo reforme konkrete. Interesi i prindërve në komunitet është marrë kështu në konsideratë.

Mary Ward Loreto Foundation

Website: www.albaniahope.com **Email:** info@marywardloreto.net

FB: MaryWardLoreto **Address:** Rr. Skenderbej, Pall. 8, Shk. 2, Ap. 5 **Tel:** +355 44 500 388



Empowering through Freedom, Justice and Sincerity

Ministria është përfshirë në prodhimin e një raporti të dytë në partneritet me KE (Komuniteti Europian), faza e parë e të cilit ka të bëjë me problemin e bulizmit. Në partneritet me Universitetin e Tiranës dhe Institutin e Studimeve Europiane, kemi arritur disa gjetje mbi të cilat mbështeten zgjidhjet të cilat do të përmbushim së bashku.

Do të ketë një takim që do të mbahet për “Ditën e Fëmijëve në Gjendje Rruge”, për të diskutuar nisma mes qeverisë lokale dhe ministrive të linjës me qëllim dhënien e ndihmës gjatë ciklit të plotë të arsimimit.

Gjatë fjalës së saj, Znj. Nora Malaj u ndal dhe në rolin dhe rëndësinë e bashkëpunimit në kuadër të mbështetjes që Ministria ofron me vendosmëri ndaj organizatave të ndryshme. Ajo falendëroi Fondacionin Mary Ward Loreto për bashkëpunimin dhe për studimin kërkimor të ACER mbi etikën në sistemin arsimor në Shqipëri.

Ministria Nikolla ka qenë mbështetja jonë kryesore për matjen e arritjeve tona në promovimin e standardeve dhe cilësisë nga niveli parashkollor në atë Master, si dhe për të na shpjeguar se përse disa çështje dhe objektiva kanë dështuar deri tani që të realizohen.

Znj Malaj falendëroi Dr. Zef Preci dhe Dr. Gerda Sula për kryerjen e hulumtimit të ACER me një kampion përfaqësues, i cili përfshiu një numër të madh mësuesish, studentësh dhe prindërisht.

Gjetje dhe rekomandime: Nëse kryejmë reforma në arsim, reformat do të kenë kosto. Por studimi i ACER ka vlerësuar me kujdes dhe ka matur shkallën e problemeve në sistem, kështu që këto reforma të propozuara do të jenë në përputhje me metodika arsimore të pranuar. Kështu, shpresojmë që të mund të ndërtojmë një sistem më të mirë arsimor i cili përmirëson standardet kurrikulare dhe praktikën mësimdhënëse.

Znj Malaj e bëri të qartë se gjetjet e hulumtimit zbulojnë të dhëna të rëndësishme. Kur mësuesit fyejnë studentët dhe kur mësuesit përdorin notat dhe autoritetin e tyre për të ndëshkuar studentët, kemi të bëjmë me aspekte të fshehura të braktisjes së shkollës që rezultojnë nga kjo praktikë jo etike. Ekzistojnë, gjithashtu, probleme madhore që kanë të bëjnë me plagjiaturën, e cila mund të trajtohet vetëm përmes një rishikimi të plotë të mënyrës se si ne kryejmë vlerësimin e punës së studentit, në veçanti punimeve të tyre. Për të shmangur këto dhe mangësi të tjera në sistemin arsimor në Shqipëri, do të jetë e nevojshme që të bëhen të gjitha përshtatjet e duhura në legjislacionin përkatës të MAS.

Arsimi është një e mirë kombëtare dhe një e drejtë universale. Le të marrim masa për ngritjen e standardeve të nevojshme për një sistem më të mirë arsimor, i cili do të sjellë drejtëpërdrejtë dhe në mënyrë të tërthortë një standard më të mirë jetese për të gjithë.

Mary Ward Loreto Foundation

Website: www.albaniahope.com **Email:** info@marywardloreto.net

FB: MaryWardLoreto **Address:** Rr. Skenderbej, Pall. 8, Shk. 2, Ap. 5 **Tel:** +355 44 500 388



Empowering through Freedom, Justice and Sincerity

Znj Malaj falendëroi të gjithë ata që morën pjesë në hulumtim, i cili prodhoi gjetje dhe rekomandime të cilat do të kenë një ndikim mbi kornizën e politikave arsimore. Shpresojmë që kjo do të reflektohet jo thjesht në nivel politik, por më e rëndësishmja, nëpër shtëpi - aty ku rriten fëmijë shqiptarë, si dhe në shkollat e të gjitha niveleve të sistemit arsimor shqiptar.

Roli i medias duhet marrë, gjithashtu, në konsideratë në kontekstin e praktikës etike në arsim, pasi studentët e të gjitha niveleve janë tashmë të ekspozuar ndaj masmedias në një shkallë të paprecedentë. Një pjesë domethënëse e edukimit të çdo fëmije – si brenda ashtu dhe jashtë shtëpisë dhe shkollës, transmetohet tani përmes një larmie të komunikimit mediatik. Prindërit dhe mësuesit, si dhe administrata politike dhe arsimore, duhet të jenë të ndërgjegjshëm rreth këtij realiteti dhe të sigurojnë që komunikimet mediatike në përgjithësi të jenë të integruara në mënyrë etike në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Znj Malaj mirëpriti sfidën e paraqitur nga hulumtimi i ACER!

Sokol Pellumbi, në përgjigje të një komenti nga Zëvendësministri, tha se *“Nëse ne nuk jemi në gjendje që të masim efektin e çdo ndryshimi të propozuar, do të ishte më mirë që të mos i propozojmë fare ato.”*

PREZANTIMI I HULUMTIMIT

Dr. Zef Preci – Drejtues i ekipit kërkimor – Drejtor i ACER

Dr. Skerdi Zahaj – ACER

Dr. Blerta Bodinaku – ACER

Fjalimi i Dr. Zef Preci

Dr. Zef Preci, Drejtor i ACER – Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike – dhe Drejtues i ekipit kërkimor që realizoi studimin *“Etika në Sistemin Arsimor në Shqipëri”* bëri një përmbledhje të shkurtër të studimit të ACER, duke përfshirë një përshkrim të procesit përgjatë të cilit ishte realizuar studimi. Ai u dha më pas fjalën bashkëpunëtorëve të tij në hulumtim për të bërë një prezantim të metodologjisë, gjetjeve dhe rekomandimeve.

ACER është një organizatë jo-qeveritare, e para e themeluar në vitin 1992 pas ndryshimit të sistemit kombëtar të qeverisjes. ACER përfaqëson një grup hulumtuesish nga fusha të ndryshme, të fokusuar kryesisht mbi çështje sociale dhe ekonomike, të cilët besojnë në ekonominë e tregut të lirë, në shoqëri të hapur dhe aspiratën që të shohin Shqipërinë si anëtare të familjes Europiane.

Gjatë 25 viteve të ekzistencës së saj, ACER është angazhuar në ndërrmarjen dhe mbështetjen e politikave publike të cilat mundësojnë një tranzicion të shpejtë dhe efikas në ekonominë e tregut, por edhe për trajtimin e çështjeve shqetësuese që shfaqen gjatë procesit të qeverisjes dhe dobësive të institucioneve shtetërore.

Mary Ward Loreto Foundation

Website: www.albaniahope.com **Email:** info@marywardloreto.net

FB: MaryWardLoreto **Address:** Rr. Skenderbej, Pall. 8, Shk. 2, Ap. 5 **Tel:** +355 44 500 388



Empowering through Freedom, Justice and Sincerity

ACER ka kryer analiza të fenomeneve sociale dhe ekonomike në kontekstin e praktikave më të mira të vendeve demokratike. Mbështetur mbi këto analiza, ACER ofron ide, qëndrime dhe opinione të cilat ndihmojnë vendimmarrjen dhe ligjëbërjen e vendit tonë.

Dr. Preci theksoi se qeveria dhe autoritetet në përgjithësi transformohen pozitivisht teksa largohen nga modeli i shtetit të centralizuar dhe bëhen gjithmonë e më shumë bashkëpunues në procesin e ngritjes së shoqërisë civile. Politikëbërja nuk është një e drejtë ekskluzive e qeverisë; përkundrazi, Qeveria duhet të zgjerojë mundësinë për dialog publik dhe konsultime me të gjithë palët e interesuara, duke përfshirë botën e akademisë dhe “sektorin e tretë” apo komunitetin e biznesit.

Sigurisht, kriza dhe sfida të vazhdueshme hasen gjatë procesit të shtet-bërjes në Shqipëri, duke përfshirë risqet e reja që paraqiten nga mungesa e respektimit dhe vijimësisë së strategjive të propozuara, të cilat bllokojnë përparimin normal të transformimit brenda shoqërisë shqiptare në përgjithësi dhe ekonomisë në veçanti.

Dr. Preci u përqendrua në marrëdhënien e përgjithshme mes qeverisë dhe botës akademike. Ai theksoi se arsimit është dhe mbetet një çështje kombëtare. “Prania sot këtu e Zëvendës Ministres Malaj na nderon” vuri në dukje Preci, “dhe dëshiroj të theksoj faktin se i gjithë stafi i MAS dhe ata nën varësinë e Ministrisë kanë qenë të hapur dhe bashkëpunues në projektin kërkimor mbi *“Etikën në sistemin arsimor në Shqipëri”*. Preçi më pas tha se një bashkëpunim i tillë me qeverinë konfirmon vullnetin politik për trajtimin seriozisht të çështjeve të rëndësishme, si: formimi qytetar i një gjenerate të re. Gjithashtu, konfirmon një përkushtim institucional për të ndërmarre hapat e nevojshme për reformimin e procesit arsimor, duke i vënë studentët në qendër të vëmendjes lidhur me politikën që po ndërmerren aktualisht dhe në të ardhmen.

Dr. Preçi ndau me audiencën “privilegjin që ai kishte patur në bashkëpunimin e mëparshëm me MAS në projekte të rëndësishme në fushën e arsimit, si dhe me Fondacionin MWL në kuadër të projektit pilot të titulluar *Korrupsioni dhe etika në sistemin arsimor*, i cili u vu në zbatim tre vite më parë, duke i paraprirë hulumtimit për të cilin jemi mbledhur sot këtu”. Ai ishte mirënjohës për idealizmin e fondacionit, për vullnetin e tij të mirë për një gjeneratë të re shqiptarësh, të cilët do ta bëjnë vendin tonë jo vetëm një vend më të mirë për të jetuar, por edhe më të sigurt në të ardhmen e tij europiane.

Pas fjalimit të z. Preçi, fjala iu dha bashkëpunëtorëve të tij në ekipin kërkimor, Dr. Skerdi Zahaj dhe Dr. Blerta Bodinaku.

Mary Ward Loreto Foundation

Website: www.albaniahope.com **Email:** info@marywardloreto.net

FB: MaryWardLoreto **Address:** Rr. Skenderbej, Pall. 8, Shk. 2, Ap. 5 **Tel:** +355 44 500 388

PREZANTIMI: METODOLOGJIA DHE GJETJET E HULUMTIMIT

Dr. Skerdi Zahaj – ACER

- ✚ (bashkëlidhur prezantimi i Dr. Skerdi Zahaj: <https://prezi.com/iqjb9ë1yqr2f/etika-ne-sistemin-arsimor/>)

Pikat Kryesore:

- Dr. Skerdi theksoi se ky hulumtim është empirik, i pari në llojin e tij.
- Rëndësia e një qasje nga poshtë-lart.
- Mësuesit vlerësojnë rëndësinë e një kodi etike, por ata nuk dinë çfarë të bëjnë kur bëhen dëshmitarë të një sjellje jo etike.
- Sistemi arsimor parashkollor dhe fillor raporton më shumë shkelje të etikës.
- Gjatë 5 viteve të fundit, mësuesit janë trajnuar rreth çështjeve të etikës.
- Mësuesit raportojnë shkelje të etikës nga prindërit dhe prindërit nga mësuesit.
- Shfaqjet e dhunshme janë një faktor i njohur nga mësuesit, por jo i raportuar.

Sokol Pellumbi: Z. Pellumbi ftoi audiencën gjatë diskutimeve në tryeza të rrumbullakëta, që të merrnin në konsideratë gjetjet e hulumtimit të prezantuara nga Dr. Zahaj.

Nora Malaj: Problemi i abuzimit seksual në universitete është ngritur nga anketat e ACER dhe do të identifikohet si një shkelje e kodit të etikës, krahas ndëshkimit përkatës për çdo shkelje. Si do të trajtohet ky problem gjatë diskutimeve paralele të tryezave të rrumbullakëta?

PREZANTIMI: PERFUNDIMET E HULUMTIMIT

Dr. Blerta Bodinaku – ACER

- ✚ (bashkëlidhur prezantimi i Dr. Blerta Bodinaku)

PIKAT KRYESORE:

- Nevojitet që Kodi i Etikës të ketë qasje nga mësuesit, nxënësit dhe prindërit.
- Nevojitet përmirësimi i kuadrit ligjor.
- Rishikimi i Kurrikulës me fokus të veçantë mbi etikën.
- Etika nuk duhet të shihet si element dytësor i sistemit arsimor, por një nga shtyllat e tij.
- Më pas kopjim dhe plagjiaturë, sidomos në sistemin universitar.
- Ndërmarrja e nismave urgjente për ndalimin e plagjiaturës.
- Kopjimi dhe plagjiatura nuk ndëshkohen dhe për këtë arsye vazhdojnë të jenë ende të pranishme.
- Komunikimi ndërmjet studentëve, mësuesve dhe prindërve mbetet i fragmentarizuar dhe jo sistematik. Nevojitet që të institucionalizohet.
- Çdokush e di që kodi i etikës ekziston nëpër shkolla, por duket se askush nuk di çfarë përmban ai.
- Të hartohen akte nënligjore në drejtim të etikës.

Mary Ward Loreto Foundation

Website: www.albaniahope.com Email: info@marywardloreto.net

FB: MaryWardLoreto Address: Rr. Skenderbej, Pall. 8, Shk. 2, Ap. 5 Tel: +355 44 500 388

SUGJERIM: Pas prezantimit të saj, Dr. Blerta Bodinaku sugjeroi se nevojitet një studim i mëtejshëm, siç është evidentuar në hulumtimin mbi *Etikën në sistemin arsimor në Shqipëri*. Është e rëndësishme që etika të studiohet brenda një kohe të arsyeshme, për t'iu përgjigjur pyetjeve se si paraqiten faktet rreth etikës në të gjitha nivelet. Kjo duhet të përfshijë studime të mëtejshme, për shembull, duke krahasuar zonat rurale me ato urbane, arsimin privat përkundër arsimit publik, me qëllim pasjen e një studimi të plotë, rast pas rasti, të etikës në arsim.

DISKUTIM PARALEL NË TRYEZA TË RRUMBULLAKËTA (Grupe me Interes të Posaçëm –GIPE)

Sokol Pellumbi: Në lidhje me të dhënat e prezantuara, u ngritën pyetje se çfarë ndjesish ju krijojnë ato, çfarë informacioni përftuat dhe çfarë veprimesh të mëtejshme do të sugjeroni në vijim, me qëllim të trajtimit pozitiv të çështjeve përkatëse? Diskutantëve të tryezave të rrumbullakëta iu kërkua, gjithashtu, që të referoheshin tek pjesa e përfundimeve të studimit, sidomos nën seksionit që ka të bëjë me sistemin arsimor.

Koha: 30 minuta dhe një pyetje nga çdo tryezë e rrumbullakët në lidhje me çështjet e trajtuara.

✚ PYETJET:

1. Çfarë ndjesie ju krijuan këto të dhëna?
2. Cilat gjetje do të dëshironit të ndanit?
3. Çfarë veprimesh të mëtejshme do të dëshironit të sugjeroni?

NDËRHYRJET NGA TRYEZAT E RRUMBULLAKËTA

Në panel:

Nora Malaj – Zëvendës Ministër MAS

Dr. Zef Preçi – Drejtues i ACER

Imelda Poole – Presidente e FondacionitMWL

Prof. Dr. Shpresa Delia – Anëtare e Bordit të Projektit tëMWL për Arsimin

Dr. Gerda Sula – Koordinatore Projekti, Projekti i MWL për Arsimin

✚ TRYEZA E RRUMBULLAKËT 10:

Pyetje: *A merr ky studim në shqyrtim elementë të tjerë krahas tre komponentëve: nxënës/student – mësues/profesorë – prindër/staf tjetër? Çfarë mund të thuhet rreth medias?*

Dr. Zef Preçi: Stafi i Ministrisë nuk ka qenë i përfshirë drejtëpërdrejtë në hulumtim. Media u përfshi në mënyrë të tërthortë. Kjo mund të jetë subjekt i një studimi të mëtejshëm. Hulumtimi u përqendrua, siç konstatoi me të drjetë, në këto tre grupe interesi fëmijë/student –mësues/profesorë – prindër.



Empowering through Freedom, Justice and Sincerity

Dr. Gerda Sula: Ne përfuam të dhëna nga tre grupet e interesit rreth rolit të luajtur nga stafi mbështetës në shkolla.

Nora Malaj: Kjo mund të arrihet përmes përfshirjes së kategorive të tjera të personelit dhe do të nevojitej një studim i thelluar, i mëtëjshëm mbi mënyrën se si media duhet të përfshihet për të kontribuar në zgjidhjen e problemeve. Ky studim duhet të diskutohet gjerësisht në mënyrë që të promovohet dhe kauza. Shumë prej kësaj varet nga programi i qeverisë. Ky studim u krye dhe u përfundua në kohën e duhur. Një rol i rëndësishëm duhet luajtur dhe nga shoqëria civile, e mbështetur nga qeveria, në drejtim të propozimit të rekomandimeve të përshtatshme. Për këtë qëllim, një fazë e dytë në vijim të studimit është mëse e dëshiruar.

Pyetje vijuese: *Dua të them, cili është roli i medias jo vetëm përsa i përket lajmeve, por edhe lidhur me përgjegjësinë e saj mbi transmetimin e filmave vizatimorë apo atyre për të rritur. A nuk duhet monitoruar dhe regulluar ajo me qëllim që të sigurohet edukimi etik i fëmijëve?*

Nora Malaj: Kjo është një qasje mjaft korrekte. Do të ishte një mundësi e jashtëzakonshme nëse MWL mund të mbështesë me një fazë të dytë në vijim, duke përfshirë median, në përputhje me gjetjet e studimit.

Imelda Poole: Kjo është një pikë shumë e rëndësishme. Nëse po flasim rreth sigurisë në internet, sidomos përsa i përket fëmijëve, po flasim në fakt rreth mbrojtjes. Kjo është një çështje kritike që ka të bëjë me ofrimin e arsimit përmes përdorimit të sigurt të internetit. Kjo mund të përfshijë mbylljen e faqeve të internetit të cilat janë të dëmshme. Mbi të gjitha, megjithatë, fëmijët duhen udhëzuar nga kujdestarët e tyre të rritur përmes diskutimeve, që i përshtaten moshës së tyre, rreth rreziqeve që paraqet internet, ashtu siç duhet vepruar dhe me të gjitha çështjet e tjera etike.

TRYEZA E RRUMBULLAKËT 13: PRINDËRIT

Pyetje: *Duke iu referuar realitetit shqiptar, a janë mësuesit/profesorët shëmbuj të mirë etik për studentët e tyre, si në drejtim të sjelljes ashtu dhe të kodit të veshjes? A ka një kod etike për këtë?*

Nora Malaj: Gjetjet e hulumtimit janë po aq interesante sa pyetja që ju ngritët. Nga 100 programe investigative, dy ose tre përbëjnë rast tipik, si raste të kodit të etikës. Ky rast është marrë nën shqyrtim nga Ministria në mënyrë që të ndërmerren veprimet e duhura.

Fakti është se përbën detyrim ligjor që përpara se mësuesi të marrë licensën për të dhënë mësim, ata duhet të kalojnë fazën e testimit. Kjo përfshin qëllimin për t'u familjarizuar me rregullat e brendshme, metodikat mësimdhënëse dhe etikën e profesionit. Këto synime nuk arrihen gjithmonë. Prandaj, ky raport parashtron rekomandime të përshtatshme.

Mary Ward Loreto Foundation

Website: www.albaniahope.com **Email:** info@marywardloreto.net

FB: MaryWardLoreto **Address:** Rr. Skenderbej, Pall. 8, Shk. 2, Ap. 5 **Tel:** +355 44 500 388

Në periudhën e gjatë të tranzicionit nga regjimi komunist, sidomos gjatë viteve '97-'99, studentët të cilët studiuuan për t'u bërë mësues nuk ishin të mirë trajnuar. Ne kemi tre kategori mësuesish: kategoria e parë përbëhet nga mësues me përvojë mësimdhënëse në të dyja sistemet dhe po japin më të mirën për t'u përshtatur, por kanë problem me teknologjinë dhe gjuhët e huaja; kategoria e dytë është ajo e mësuesve të rinj, të zellshëm për të përthithur dhe praktikuar metoda innovative, të cilat ata mendojnë se duhet të jenë pjesë e brendshme e sektorit; dhe kategoria e tretë përbëhet nga mësues të moshës 30-35 vjeç të cilët kanë përvojë vetëm në shkollat e sistemit post-Komunist. Mësues të secilës prej këtyre kategorive duhen vlerësuar në mënyrë të ndarë, sidomos kur flitet për rubrikën e praktikës etike.

Nuk është se nuk kemi modele të mira të cilave mund t'iu referohemi. Në fund të fundit, ne kemi modele të mira të mbështetura mbi përvoja dhe praktika të mira të vendeve fqinje dhe më tej. Për këtë arsye, nuk është nevoja t'ia nisim nga zero, por duhet që të mbështetemi mbi praktikën e mira të vendeve të tjera dhe të vemë në zbatim mësimet e nxjerra prej tyre.

Dr. Zef Preci: Qëllimi i këtij sesi është që të trajtojë pyetje që kanë të bëjnë me hulumtimin. Ju lutem parashtroni pyetje që kanë të bëjnë me raportin, në mënyrë që ne të kemi mundësi t'i trajtojmë ato në mënyrë të përshtatshme.

Dr. Blerta Bodinaku: Do të dëshiroja të bëja dy komente në lidhje me programet investigative dhe median. Studentët dhe prindërit u drejtohen mediave kur ata hasin sjellje jo etike apo ndonjë shkelje të etikës për arsye se ata nuk kanë besim në sistemin e drejtësisë. Prandaj, këshillohet që dhe media të ndihmojë në trajtimin e problematikave të shkeljes së etikës. Popullata e përgjithshme është e paqartë në atë se çfarë duhet të bëjë kur hasin praktika jo etike në shtëpi apo shkollë. Këtu media mund të ketë një rol kritik për promovimin e praktikave më të mira etike mes popullatës si e tërë.

Dr. Gerda Sula: Ajo çfarë ndodh është se etika nuk shpjegohet, ajo jepet si shembull. Praktika etike ka kaluar një fazë traumatike në të cilën ka patur për fat të keq një dykuptimësi në atë se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar. Ka një kod etik për mësuesit, por jo me procedura të përkufizuara qartë, apo koncept të qartë të asaj çfarë është e drejtë apo e gabuar. Ne duhet të diskutojmë rreth rasteve të shembujve të praktikave të mira të etikës në profesionin e mësuesisë, dhe ky është një rekomandim i studimit. Ka mësues të cilët arrijnë që të japin shembuj të praktikave të përshtatshme, dhe kjo është arsyeja se përse ne kemi planifikuar që të japim çmime me qëllim për të vlerësuar mësuesit më të mirë në shërbim, si dhe mësuesit më të mirë të studentëve.

TRYEZA E RRUMBULLAKËT 7

Pyetje: *Të ashpërsohen ndëshkimet për rastet abuzive. Nuk ka ndonjë masë shtrënguese për përdorimin e lëndëve narkotike si dhe për sjelljet abuzive.*



Empowering through Freedom, Justice and Sincerity

Nora Malaj: Këto sjellje nuk i përkasin Kodit të Etikës, por Kodit të Procedurës Penale, pasi ato janë përcaktime ligjore. Nëse ka raste të dyshuara, duhet kërkuar menjëherë ndërhyrja e policisë.

Question: Zbatimi mbetet i vështirë.

Nora Malaj: Kjo ka të bëjë me mekanizmin e referimit. Masat në kodin e etikës duhen forcuar. Shteti po punon mbi strategjinë kundër drogave dhe atë kundër diskriminimit.

Dr. Gerda Sula: Në këtë rast përballemi me frikën e mësuesve –ata janë të frikësuar. Procesi i mësimdhënies dhe të nxënies është një proces i vazhdueshëm. Masat korrigjuese duhet të merren sa më parë. Fëmijët duhet të mësojnë në shtëpi dhe në shkollë që të marrin përgjegjësi që në moshë të hershme dhe të bëhen qytetarë me vlera të mirë organizuara, të cilat u mbijetojnë sprovave të situatave të vështira.

Dr. Skerdi Zahaj: Praktikant ndëshkuese, megjithëse të nevojshme, nuk janë përgjigja. Ne duhet të nxisim shembujt pozitivë tek të gjithë palët e interesuara, të rinj dhe të vjetër.

Imelda Poole: Sipas meje, dëshira më e rëndësishme e një fëmije është që të ndodhet në një mjedis të sigurtë.

Sokol Pellumbi: Psikologu i shkollës ka një rol të rëndësishëm në këtë pjesë.

TRYEZA E RRUMBULLAKËT: INTELIGJENCA EMOTIVE

Pyetje 1: Duke qenë se ne jemi kundër masave shtrënguese, nevoja për të pasur politika të mira shfaqet mjaft qartë. Do të dëshiroja të sillja në vëmendjen tuaj faktin se në përfundim fëmijët rriten në shtëpi dhe edukohen nëpër shkollë, të cilat mbështeten mbi etikën. Ka programe për të mësuarin social dhe emotiv. A nuk duhet që të zbatohet dhe ne të njëjtat lloje programesh nëpër shkollat tona?

Question 2: A është e mundur që programi i shkollës të përfshijë dy orë të kushtuara edukimit social dhe emotiv?

Nora Malaj: Cilat janë sfidat e përbashkëta? Për edukatën kemi orë kurrikulare dhe jashtë kurrikulare. Kemi një sistem ligjor të qartë dhe të mirë perkufizuar, duke qenë se jemi mbështetur mbi ekspertë të huaj dhe praktikant më të mira. Për fat të keq, institucioni –që është shkollë, nuk e sheh rolin e tij si një *koordinator*, të mbështetur mes administratës, stafit dhe studentëve, por përkundrazi si një *organ kontrollues* që bën ligjin. Ne nuk i konsiderojmë shërbimet psiko-sociale si një shërbim i perkushtuar, por si një këshillues për zgjidhjen e problemeve të mëdha.

Mary Ward Loreto Foundation

Website: www.albaniahope.com Email: info@marywardloreto.net

FB: MaryWardLoreto Address: Rr. Skenderbej, Pall. 8, Shk. 2, Ap. 5 Tel: +355 44 500 388



Empowering through Freedom, Justice and Sincerity

Dr. Blerta Bodinaku: Ka studime të cilat tregojnë se edukimi etik përshtatet mjaft mirë me inteligjencën emotive. Praktika bashkëkohore e integritetit të etikës në edukim sugjeron se të mësuarit e etikës në kontekstin e lëndëve dhe orëve të posaçme është mënyra e duhur.

Prof. Dr. Shpresa Delia: Mësuesi ka një rol të rëndësishëm si në shkollë ashtu dhe në familje, dhe duhet që ta marrë përsipër këtë përgjegjësi. Nuk është nevoja që mësuesi të ketë orë të përcaktuara mësimore për ngulitjen e etikës. Nga momenti që ai/ajo futet në klasë, ai/ajo jep një shembull përmes sjelljes së tij/saj me fjalë dhe me veprime. Etika është ligji. Bazamenti për sjelljen etike është familja. Për këtë arsye, duhen organizuar takime në komunitet. Mësuesit duhet të diskutojnë dhe shfaqin në praktikë njëkohësisht sjellje të shkëlqyera etike. Sa më shumë bashkëpunim që të ketë midis shkollës, familjes dhe shoqërisë, aq më shumë do të ecim përpara. Duhet që të mësojmë nga këto rekomandime pasi ato janë shumë konkrete, me masa të posaçme për t'u ndërmarrë.

Nora Malaj: Në përvojën botërore, etika është pjesë e sistemit arsimor para-shkollor. Ne duhet ta përfshijmë atë si një paketë, si një broshurë në këtë nivel arsimor, pra në kopshte. Etika e paraqitur si shembull i përkushtuar do të ketë vlera të pandara.

Rekomandim: Etika duhet parë si një luftë kundër korrupsionit. Ky është problemi kyç.

Nevojitet që të skicohen programe të sakta për t'u përfshirë në sistemin arsimor. Gjithashtu, nevojiten dhe politika të përshtatshme. Me arsimin si një prioritet, nevojiten përpjekje të tilla që garantojnë se kjo nuk mbetet diçka e fragmentarizuar. Nga ana tjetër, të bësh ndryshime në sistem ka kosto të konsiderueshme, kosto të cilat mund të kërkojnë 15 vite deri sa të sjellin rezultate. Duhet të kemi një qasje të përkushtuar e cila shkon përtej marrëdhënieve dhe raporteve, me qëllim që t'ia arrijmë dhe vemë në zbatim ato.

TRYEZA E RRUMBULLAKËT:

Pyetje: Sipas raportit, ka një nivel të ulët të raportimit të abuzimeve seksuale. A mendoni se kjo pasqyron realitetin?

Dr. Skerdi Zahaj: Gjithçka që ne kemi është një mesatare, e cila në vetvete është e nën-raportuar. Nuk e dimë se cili është realiteti. Abuzimi seksual shfaqet në fshehtësi dhe nuk mund të zbulohet nga mësuesit dhe prindërit. Duhet të kryhen më shumë studime për të pasur të dhëna statistikore më të shumta.

Mary Ward Loreto Foundation

Website: www.albaniahope.com **Email:** info@marywardloreto.net

FB: MaryWardLoreto **Address:** Rr. Skenderbej, Pall. 8, Shk. 2, Ap. 5 **Tel:** +355 44 500 388

TRYEZA E RRUMBULLAKËT 17

Pyetje: A janë përfshirë në hulumtim shkollat private? A janë përfshirë mësues të moshave të ndryshme? Sa e favorshme është struktura brenda shkollave?

Dr. Zef Preci: Shkollat publike kanë qenë fokusi i studimit për shkak të faktit se një numër i konsiderueshëm i mësuesve që japin mësim në shkollat private janë pjesë e sistemit shtetëror.

Studimi kishte për qëllim jo vetëm të bënte matje, por edhe të kontribuonte në një qasje pro aktive nga ndëshkimi në parandalim.

TRYEZA E RRUMBULLAKËT 1:

Pyetje: Unë do të doja të përgëzoj organizatorët për formatin e këtij takimi, i cili më pëlqen shumë, veçanërisht çështja e diskutimit: etika. Pas 99 vjetësh jemi këtu sot të gjithë bashkë për të diskutuar mikro-procesin, mikro-shkollën dhe zhvillimin e arsimit. A mendoni se ka ardhur momenti për të bërë arsimin në përgjithësi dhe shkollat në veçanti, fokus të një konvente kombëtare?

Dr. Zef Preci: Të gjitha qeveritë shqiptare kanë pasur arsimin mes prioriteteve të tyre. Duhet të bëjmë dallimin mes menaxhimit të mirë dhe menaxhimit të përsosur. Mbi të gjitha, duhet të kuptojmë se si ta bëjmë të mundur që studentët tanë të bëhen qytetarë të denjë.

Nora Malaj: Kjo iniciativë e ndërmarrë në nivel kombëtar demonstroi hapat e nevojshëm për rritjen e një ideje. Procesi i arsimit duhet të jetë tashmë avangardë për të ecur përpara. Grupet e ekspertëve shpesh bashkohen me qëllim ngritjen e pritshmërive. Imelda Poole na ofron përvojën e saj perëndimore në bazë të praktikave më të mira. Edukimi është promovuar dhe praktikuar si një e mirë kombëtare. Është e rëndësishme që të shqyrtojmë politikat arsimore me dëshirën për të përmirësuar. Unë nuk jam për të promovuar ndëshkimin si një mënyrë për të realizuar gjërat. Përkundrazi, le të përshtasim dhe rregullojmë sjelljen duke u mbështetur në bashkëpunim dhe le të bashkëpunojmë. Le të jenë të gjithë pjesë e procesit të ndryshimit.

Dr. Gerda Sula: Dëshiroj të përmend shembullin e Sllovenisë. Pa marrë parasysh se cila parti vjen në fuqi, struktura nuk ndryshon.

KOMENTET PËRFUNDIMTARE

✚ PËRMBLEDHJE: OPINIONE NGA PJESËMARRËSIT

Dr. Tomi Treska – Ekspert i Arsimit

Dr. Treska ndau me audiencën mendimet e tij mbi hulumtimin, zhvillimet e konferencës dhe diskutimet paralele në tryezat e rrumbullakëta.

Ai uroi ACER-in për ndërmarrjen dhe kryerjen e këtij hulumtimi, si dhe për identifikimin e çështjeve të etikës, apo mungesën e tyre, nga parashkollorët deri në sistemin e arsimit universitar. Dr. Treska vlerësoi MWL për nxitjen e studimit. Më pas, ai falënderoi MAS që pati guximin të verë në zbatim raportin duke u mbështetur në reputacionin e OJQ-së MWL.

Dr. Treska më tej theksoi se gjetjet e raportit janë të besueshme dhe të vlefshme dhe se raporti është në nivelin e kërkimit shkencor, bazuar në metodologjinë e përdorur, me gjetje realiste dhe objektive. Dr. Treska falënderoi studiuesit dhe autorët e raportit për paanshmërinë e tyre.

Studimi nuk ishte një përpjekje për të zbuluar diçka, por për të ndryshuar diçka. Rekomandimet janë shumë të qarta dhe mund të shërbejnë për një plan veprimi. Atmosfera ishte konstruktive, bashkëpunuese, njohëse dhe ndërvepruese, si në panele ashtu edhe në çdo tryezë të rrumbullakët.

Procesi: Dr. Treska vuri në dukje se në diskutimet e tryezave të rrumbullakëta kishte diskutime dhe debate, jo grindje. Në këto tre orë kemi demonstruar se ne jemi një model i drejtëpërdrejtë i funksionimit etik. Diskutimet në tryeza të rrumbullakëta funksionuan siç duhet dhe ai falënderoi vullnetarët që morën shënime dhe raportuan përsëri në asamblenë e përgjithshme. Z. Treska vuri në dukje se kishte një shqetësim pozitiv përse i përket pyetjeve drejtuar panelit. Diskutimet ishin konstruktive dhe serioze dhe ai e vlerësoi vizitën e moderatorit Sokol në çdo tavolinë për të orientuar dhe inkurajuar debatin produktiv.

Shënimet dhe mendimet e fundit të Dr. Treska:

Së pari le të pranojmë se kushtet për një raport të tillë ishin pjekur. Raporti është i domosdoshëm dhe ka përfshirë një sasi voluminoze pune cilësore.

Pyetja e tryezës së rrumbullakët 10: fokusi i studimit dhe i tre aktorëve kyç të tij: studentët, prindërit dhe mësuesit. Studimi nuk përfshiu asnjë actor tjetër në sistemin arsimor.

Ai i konsideroi pyetjet lidhur me median - filmat dhe produktet e tjera të mediave - tejet interesante. Ato nuk ishin objekt i studimit, por rekomandimet e tij ndihmojnë për të ndryshuar kulturën dhe për të përmirësuar moralin.

Pyetja e tryezës së rrumbullakët 13: Mungon zbatimi në praktikë, kemi ligje të përsosura. Praktika më e mirë mësimore duhet të promovohet dhe të zbatohet nga secili mësues / profesor, dhe këto praktika dhe shembuj të mirë duhet të ndahen dhe me shkollat e tjera. Në rastet e shkeljeve të etikës, ato duhet të raportohen vazhdimisht. Është jashtëzakonisht e nevojshme që të rifitohet besimi i publikut në sistem.

Ekziston një nevojë e menjëhershme për:

- Ri-hartimin e kodit të etikës dhe pasjen e strukturave të qarta për parandalimin e shkeljeve etike.
- Zhvillimin e një konteksti ligjor që ndan shkeljet etike nga shkeljet penale. I pari duhet të trajtohet ndryshe, sepse ka të bëjë me moralin dhe vlerat.
- Vendosjen e protokolleve të nevojshme përmes një procesi vendimmarrës gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës.

Sipas parametrave të BE-së, disiplina në një shkollë demokratike duhet të jetë e dukshme. Së pari dhe më kryesorja, studentët duhet të ndihen të sigurt.

Inteligjenca emotive dhe edukimi etik duhet të jenë pjesë përbërëse e njëri-tjetrit. Edukimi i etikës duhet të përfshihet në programet kurrikulare / jashtëshkollore në të gjitha nivelet e arsimit, duke filluar nga sistemi parashkollor. Trajnimi i mësuesve është pra një prioritet i MAS.

Fëmijët tanë do të na frymëzojnë në qëllimin tonë për ndërtimin e një themeli etik në arsim!

✚ PËRGJEGJËSIA E MINISTRISË PËR NJË ARSIM MË ETIK

Nora Malaj – Zëvendës Ministër i MAS

Nora Malaj vlerësoi punën e bërë për raportin e studimit dhe ftoi bashkëbiseduesit të bashkëpunojnë në sfidat e ardhshme dhe të bëjnë përpjekje të përbashkëta drejt zgjidhjes së tyre.

Zëvendësministra konfirmoi se Ministria do të organizojë takime për mësimdhënësit në nivelin para universitar dhe universitar. Do të krijohet një komision ad hoc i cili do të përfshijë përfaqësuesit e aktorëve relevantë si dhe do të punojë për ndryshime në legjislacion.



Empowering through Freedom, Justice and Sincerity

Ne jemi të hapur për bashkëpunim në mënyrë që të theksojmë ato çështje që nuk janë raportuar në studimin e parë dhe do të punojmë në partneritet me Fondacionin MWL për të vazhduar në fazën tjetër.

Znj. Malaj theksoi nevojën për të kryer një studim të fazës së dytë bazuar në tri çështjet e mëposhtme kryesore:

1. Modeli i etikës: si t'u ofrohet ai mësuesve, por edhe profesorëve.
2. Si të raportohet abuzimi seksual, i cili është i fshehur.
3. Si të përfshihen mediat në nevojën për të komunikuar çështjet e ngritura nga studimi ACER dhe diskutimet e Konferencës.

Këto tri çështje të rëndësishme u ngritën gjatë diskutimeve në konferencë. Ata do ta bëjnë këtë raport të parë të studimit akoma më të plotë.

✚ QASJA E MWL NË TRAJTIMIN E ÇËSHTJEVE ETIKE NË ARSIMIN NË SHQIPËRI

Imelda Poole – Presidente e Fondacionit MWL

Dëgjuam gjithçka. Tani duhet të reflektojmë. Kemi tashmë një projekt pilot për të mësuarin përmes shërbimit, dhe po punojmë në bashkëpunim me një shkollë në Lezhë për demokratizimin e edukimit. Po bëjmë atë që kemi premtuar. Po planifikojmë që të prezantojmë këtë raport edhe në qytete të tjera.

Konferenca përfundoi në orën 13.45. Më pas kishte drekë.

Përgatitur nga:

Sonila Kocli

Tirana, April 19th, 2017

Mary Ward Loreto Foundation

Website: www.albaniahope.com **Email:** info@marywardloreto.net

FB: MaryWardLoreto **Address:** Rr. Skenderbej, Pall. 8, Shk. 2, Ap. 5 **Tel:** +355 44 500 388



Empowering through Freedom, Justice and Sincerity



Mary Ward Loreto Foundation

Website: www.albaniahope.com **Email:** info@marywardloreto.net
FB: MaryWardLoreto **Address:** Rr. Skenderbej, Pall. 8, Shk. 2, Ap. 5 **Tel:** +355 44 500 388
